

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84-R77.1

Data: 18 gusht 2011

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE I

Para: Gjykatësit Alphons Orie, Kryegjykatës
Gjykatësit Bakone Justice Moloto
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Urdhër: 18 gusht 2011

PROKURORI

k.

SHEFQET KABASHIT

PUBLIK

**URDHËR PËR DHËNIEN E INCIZIMEVE/FILMIMEVE DHE LEJIMIN E
FOTOGRAFIMIT**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Serge Brammertz

Të Akuzuarit

Z. Shefqet Kabashi

DHOMA GJYQËSORE I e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare Të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”);

DUKE MARRË SHËNIM se **SHEFQET KABASHI** (“I Akuzuari”) u arresua në Mbretërinë e Vendeve të Ulëta më 17 gusht 2011 dhe u transferua në selinë e Tribunalit më 18 gusht 2011;

DUKE MARRË SHËNIM se është caktuar që paraqitja e parë e Të Akuzuarit të mbahet më 19 gusht 2011;

DUKE MARRË PARASYSH paragrafin (D) të Rregullës 81 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”) ku përcaktohet se Veç Sekretarit, edhe Dhoma Gjyqësore mund të lejojë fotografimin, filmimin ose incizimin zanor të procesit gjyqësor;

BAZUAR NË Rregullat 54 dhe 81 (D) të Rregullores;

URDHËRON që në varësi të çfarëdo urdhri tjetër të Dhomës:

1. marrja e fotografive të palëvizshme nga fotografët e caktuar në fillim të krejt procedimit në këtë çështje lejohet sipas udhëzimit të Shefit të Sigurimit të Shërbimit të Sigurimit të Tribunalit; dhe
2. lejohet dhënia e filmimeve/incizimeve të të gjitha seancave publike të këtij procesi gjyqësor, siç përcaktohet nga Sekretari i Tribunalit.

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatësi Alphons Orië
Kryegjykatës

Sot, më 18 gusht 2011
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit]